



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:065977  
Datë: 06.08.2024  
Numri i dokumentit: 06021034

**Kom.Dh.Shk.II.nr.813/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, me gjyqtarin individual Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komuna e Vitisë - Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit-Sektori i Tatimit në Pronë, kundër debitorit Eco Higjiena Sh.A., me seli në Gjilan, në çështjen përmbarimore, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.789/23 dt. 26.09.2023, më datën **05.08.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e kreditorit Komuna e Vitisë - Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit-Sektori i Tatimit në Pronë, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.789/23 dt. 26.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.789/23 dt. 26.09.2023, e ka pranuar si i bazuar prapësimi i debitorit Eco Higjiena Sh.A., me seli në Gjilan, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr.42/2023, i lejuar me datë 01.02.2023, nga Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, është anuluar.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor kreditorit ( *me pretendimet si në ankese*) me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, të priset aktvendimi KPPP.nr.789/23 dt. 26.09.2023 dhe çështje të kthehet në rivendosje, dhe të mbetet në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.42/2023, i lejuar me datë 01.02.2023 të lejuar nga përmbaruesi privat Kushtrim M. Musa.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Fatura e tatimit në pronë Nr.3354694700 dhe me numër të tatimpaguesit 2261810 të datës 24.01.2022, ka nxjerr Urdhrin Përbarimor P.nr.42/2023, i lejuar me datë 01.02.2023, me të cilin është lejuar përbarimi ndaj debitorit për realizimin e borxhit në shumë prej 2,753.37 euro, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor, me arsyetim se nuk është specifikuar periudha kohore për të cilin është krijuar obligimi i debitorit dhe në këtë rast nuk është e kjo nëse kreditori e ka filluar procedurën përbarimore brenda afatit ligjor apo nëse kërkesa e kreditorit është parashkruar. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin, ashtu që urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe se nuk gjen mbështetje në nenin 71 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se është e specifikuar periudha kohore e cila është prej viti 2005 deri në vitin 2022 dhe se janë respektuar të gjitha afatet ligjore, mirëpo kejt qëllimi i debitorit është prolongimi i procedurës përbarimore. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.789/23 dt. 26.09.2023, e ka pranuar si i bazuar prapësimi i debitorit Eco Higjiena Sh.A., me seli në Gjilan, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr.42/2023, i lejuar me datë 01.02.2023, nga Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, është anuluar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas analizimit të propozimit për përbarim e konteston se i njëjti është lejuar mbi bazën e dokumentit, përkatësisht Fatura e tatimit në pronë Nr.3354694700 dhe me numër të tatimpaguesit 2261810 të datës 24.01.2022. Prandaj, mbi këtë bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 21 dhe 22 par.1 nën par. 1.9 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në

pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore.

Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret Fatura e tatimit në pronë Nr.3354694700 dhe me numër të tatimpaguesit 2261810 të datës 24.01.2022, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër dhe mbi bazën e dokumentit përmbartimor, t'ia paguaj shumën prej 2,753.37 €, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet për të qene dokument përmbartimor me titull ekzekutiv, sepse nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 21 dhe 22 par.1 nën par. 1.9 të LPP-së. Gjithashtu sipas faturës së tatimit në pronë e paluajtshme referuar Ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronë e paluajtshme neni 27 përcakton se: *"Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) dite kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori"*, ndërsa me nenin 30, par. 1 të këtij ligji përcaktohet se *"Nëse pas njeqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën e treqind (300) Eurove"*. Ndërsa, neni 30, par. 7 i këtij ligji parasheh se: *"Brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara, autoriteti që ka marrë vendimin kërkon autoritetit kompetent përmbartues përmbartimin e vendimit dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën përmbartimore. Një kopje e propozimit për përmbartim së bashku me dokumentet e bashkëlidhura i dërgohen menjëherë debitorit"*.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbartimi, Fatura e tatimit në pronë Nr.3354694700 dhe me numër të tatimpaguesit 2261810 të datës 24.01.2022, nuk përben bazën juridike për caktimin e përmbartimit, pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, në të cilin përcaktohet se *"Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër"* dhe nenit 22 par.1 nënpara. 1.9 të LPP-së, me të cilin përcaktohen se ky dokumente nuk përmbanë tiparet e një vendimi të organit administrativ ku përcaktohet se *"dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbartues"*. Në rastin konkret dokumenti, e mbi bazën e së cilës është paraqitur propozimi për përmbartim nga ana e kreditorit dhe është lejuar urdhri përmbartimor nga ana e përmbartuesit privat, nuk ka tipare të titullit ekzekutiv dhe tipare të përmbartueshmërisë. Prandaj nga të lartcekurat gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbartimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për ekzekutimin e tij.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.42/2023, i lejuar me datë 01.02.2023.

Numri i lëndës: 2023:065977  
Datë: 06.08.2024  
Numri i dokumentit: 06021034

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.813/24 dt.05.08.2024**

**Gjyqtar,**  
**Faton Bajrami**